REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
MUNICIPAL GJILAN - OPŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYESI

# PLANI KOMUNAL PËR INTEGRITET
# 2024 - 2026

*Periudha korrik-dhjetor 2024*

***Janar 2025***

## Deklarata e Integritetit

Kryetari i Komunës së Gjilanit, z.Alban Hyseni, së bashku me drejtorët komunal, kanë prezantuar raportin e punës për vitin 2024 për Komunën e Gjilanit para shumë qytetarëve entuziastë dhe të interesuar. Ky raport reflekton angazhimin tonë për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve, duke kontribuar në kushte më të mira për jetesën dhe biznesin e komunitetit lokal.

Jemi angazhuar që edhe  brenda periudhës korrik – dhjetor 2024, të realizojmë hapa të rëndësishëm për të forcuar administratën komunale dhe për të ofruar shërbime më të mira.

Jemi të vetëdijshëm për rrezikun e keqpërdorimeve dhe korrupsionit, dhe për këtë arsye menaxhojmë me përgjegjësi dhe llogaridhënie. Drejtuesit tanë zbatojnë politikën e "zero tolerancë" ndaj korrupsionit. Stafi ynë është përgjegjës për të raportuar çdo incident, duke siguruar konfidencialitetin e informacionit dhe përkrahjen për çdo qytetar që i drejtohet me denoncime.

Inkurajojmë qytetarët të raportojnë rastet e korrupsionit përmes linjës telefonike kundër korrupsionit. Ne do të vazhdojmë të identifikojmë rreziqet e mundshme dhe të forcojmë integritetin brenda administratës komunale, duke synuar përmirësime të vazhdueshme.

Të gjithë jemi të angazhuar për parandalimin dhe hetimin e çdo shkeljeje të integritetit, duke vepruar me ndershmëri dhe profesionalizëm. Do të shmangim konfliktet e interesit dhe nepotizmin, duke zbatuar politikën tonë parandaluese me përpikëri.

Si Kryetar i Komunës së Gjilanit, e shpall këtë deklaratë si një angazhim për të përmirësuar vazhdimisht menaxhimin e integritetit në institucionin tonë, me synimin që edhe brenda kësaj periudhe korrik – dhjetor 2024 kemi bërë hapa të prekshëm dhe të rëndësishëm.

Kryetari i Komunës së Gjilanit
z. Alban Hyseni, kryetar

**Hyrja**

Në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe duke iu referuar "Metodologjisë së Planeve të Integritetit", të gjitha institucionet janë të detyruara të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit.

Komuna e Gjilanit ka realizuar këtë detyrim duke hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024-2026.

Ky plan, i cili ka një periudhë zbatimi trevjeçare dhe përditësohet çdo vit, shërben si një instrument të rëndësishëm për vlerësimin e nivelit të integritetit brenda institucionit. Ai ofron masa të strukturuara për menaxhimin e integritetit, me qëllim që të arrihen objektivat e përcaktuara për këtë fushë.

Planin për Integritetit për periudhën korrik – dhjetor 2024 e gjeni të publikuar në ueb faqe të Komunës së Gjilanit

Linku:

**https://kk.rks-gov.net/gjilan**

Plani thekson përkushtimin e komunës së Gjilanit për të forcuar kontrollin e aktiviteteve operative në të gjitha sektorët e veprimit të komunës. Ai përshkruan masat e bazuara në analizën e rrezikut për të arritur objektivat e institucionit, duke u fokusuar në forcimin e sundimit të ligjit dhe promovimin e vlerave dhe standardeve profesionale.

Kjo qasje sistematike dhe e dokumentuar është e nevojshme për të garantuar një nivel më të lartë të integritetit dhe transparencës në administratën lokale, duke kontribuar kështu në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të përgjegjshme.

## PERMBAJTJA E PLANI TE INTEGRITET

Përmban elementet e mëposhtëm:

- një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- informacion për fushëveprimin e institucionit dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion;
- llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- masat ekzistuese të kontrollit;
- masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e hartimit dhe zbatimit të planit të integritetit;
- të dhëna të tjera, në përputhje me Metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- Rritjen e mundësive që institucionit të arrijë objektivat e menaxhimin e integritetit;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontrolleve ndaj rreziqeve të identifikuara;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Institucioni.

## Qëllimet e Planit të Integritetit

- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit;
- Planifikim i menaxhimit të rrezikut ndaj integritetit në institucion.

## Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- Faza e parë**:** Drejtuesi/personi përgjegjës te institucionit merr vendim për emërimin e një Koordinatorit dhe Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga anëtarë kredibilvarësi të kompleksitetit të institucioni ose numrit të punonjësve. Grupi punues shqyrton kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).

- Faza e dytë**:** Grupi punues ka mbajtur takime të rregullta me qëllim të përpunimit të të dhënave respektivisht përcaktimit të fushave të rrezikut dhe identifikimit të rreziqeve. Ndër të tjerash, takimet janë mbajtur më datë: 16.02.2023, 13.12.2023 dhe 12.01.2024. Përpos takimeve, jemi konsultuar në vazhdimësi përmes emailit dhe kemi kërkuar që anëtarët e grupit të dërgojnë komentet dhe propozimet e tyre në raport me Planin.

- Faza e tretë**:** Grupi punues ka përdorur të dhënat e siguruara për t’i përpiluar tabelat e rrezikut dhe të adresoj cenueshmërinë e integritetit dhe propozon masat për përmirësim. Në fund, komuna publikon planin e integritetit dhe miraton masat për përmirësimin e integritetit për periudhën tre (3) vjeçare.

## Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësime duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda një institucion, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

## Fushat e rrezikut

### Fushat e përgjithshme të Rrezikut

***Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë***:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve;
- Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave; dhe
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit.

### Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Institucionit.

***Fushat e specifike të rrezikut shembull janë:***

- Auditimi i brendshëm;
- Prokurimi publik;
- Menaxhimi i kontratave publike;
- Zhvillimi ekonomik lokal dhe bujqësia;
- Planifikimi urban dhe rural;
- Standardet e ndërtimit dhe kontrolli;
- Inspektimet;
- Arsimi publik;
- Shëndeti publik.

# Tabela për Zbatimin e Planit të Integritetit-Komuna e Gjilanit – periudha korrik – dhjetor 2024

| Të dhënat e Planit të Integritetit | | | | | | Raportimi i zbatimit | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Fusha e rrezikut** | **Përshkrimi i Rrezikut** | **Masa e propozuar** | **Njësia/zyrtari përgjegjës** | **Afati i realizimit** | **Veprimet e ndërmarra** | **Niveli i realizmit** | **Mjetet e verifikimit** | **Vështirësitë** | **Rekomandimet** |
| 1. | DREJTIMI DHE MENAXHIMI | Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente | Prezantimi i raportit të punës për Komunën e Gjilanit para shumë qytetarëve entuziastë dhe të interesuar | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, së bashku me drejtorët komunal, kanë prezantuar raportin e punës për Komunën e Gjilanit para shumë qytetarëve entuziastë dhe të interesuar.<br><br>Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit janë të përcaktuara qartë dhe janë të aksesueshme për publikun, që tregon për transparencë në menaxhimin e komunës. Megjithatë, mospajtimet mes pozitës dhe opozitës në Kuvendin e Gjilanit janë një sfidë që vazhdon të ndikojë brenda institucioneve. | **E realizuar**<br><br>Gjate takimit janë paraqitur arritjet gjatë këtij mandati dhe projektet që na presin në vitin 2025 | https://gjilani.info/hyseni-do-te-vazhdojme-te-punojme-pa-u-ndalur-per-nje-komune-me-te-mire-per-te-gjithe/ | Vazhdojnë mospajtimet pozitë-opozitë në Kuvendin e Gjilanit | Raportet para Asamblesë Komunale dhe para qytetarëve do te jene ne përputhje me ligjet ne fuqi. |
| 1.1 | | Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente. | Rishikimi i Planit Zhvillimor | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Kryetari i Komunës së Gjilanit me date 19/09/2024 nxjerrë vendimin për Themelimin e Ekipit Bazë Komunal të Planifikimit<br><br>Kryetari i Komunës së Gjilanit me date 19/09/2024 nxjerrë vendimin për Caktimin Koordinatorit për Procesin e Hartimit te Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) bazuar ne këtë vendim z. Ali Arifi drejtor / Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje te Mjedisit<br><br>Po ashtu kryetari i komunës ka nxjerre Vendimin për Themelimin e Ekipit Mbështetës për Sistemin e te Dhënave te Planit Zhvillimor Komunal<br><br>Po ashtu kryetari i komunës ka nxjerre Vendimin për Themelimin e Ekipit Mbështetës për Sistemin e te Dhënave te Planit Zhvillimor Komunal | **Në proces**<br><br>Vendimet e 19/09/2024, të Hartimit të Planit Zhvillimor Komunal, po zbatohen. | 0001. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji<br><br>Shiko te bashkangjitura vendimet! | Komuna e Gjilanit është në bashkëpunim aktiv me komunat fqinje si Partesh, Novobërdë dhe Ranilluk \| procesi i decentralizimit dhe harmonizimi i PZHK është i domosdoshëm | PZHK do të mundësont e integrimin e kërkesave dhe nevojave të qytetarëve në procesin e zhvillimit. |
| 1.2 | | Mos përfshirja e të gjitha fushave | Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesv | Kryetari i Komunës , | TM3 dhe TM4 2024 | Vendimet e Kryetarit të Komunës së Gjilanit me date 19/09/2024 sa i përket PZHK përfshin ne | **Në proces**<br><br>pritet qe ne 3-mujorin | | Vazhdojnë mospajtimet pozitë-opozitë në | Palët duhet të angazhohen në një |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përkatëse në Planin Zhvillimor. | e të të gjitha fushave përkatëse si dhe qytetarëve në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës | Drejtorit Komunale | | game te gjere te eksperteve ng te gjitha fushat dhe drejtorit përkatës | (TM1) te vitit te përcillet për aprovim | Shiko te bashkangjitura vendimet! 0002. Vendimi per PZHK - Komuna e Gji | Kuvendin e Gjilanit | dialog të hapur dhe të ndershëm |
| 1.3 | | Opinion publik negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal | Përditësimi i informatave në ueb faqen e Komunës për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës | Kryetari i Komunës, Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Zyra për Informim e Komunës së Gjilanit ka një rol kyç në sigurimin e transparencës dhe komunikimit efektiv me qytetarët dhe mediat.<br><br>Përmes përditësimit të vazhdueshëm të informacionit në uebfaqen zyrtare të komunës, kjo zyrë kontribuon në njoftimin e publikut për të gjitha aktivitetet dhe vendimet që ndodhin në nivel lokal. | **Gjithherë**<br><br>Kjo siguron që qytetarët, mediat dhe palët e interesuara të kenë akses të drejtpërdrejtë dhe të shpejtë në informacionet që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme | https://kk.rks-gov.net/gjilan/category/vendimet/#all | Në muajin dhjetor, Komuna e Gjilanit ka përballuar disa vështirësi të mëdha për shkak të problemeve me rrjetin qeveritar dhe mungesës së energjisë elektrike. | Përmes këtij procesi, synojnë të krijojnë një lidhje të ngushtë dhe të besueshme me qytetarët, |
| 1.4 | | Përfshirja e vazhdueshme e shoqërisë civile në hartimin e politikave publike komunale. | Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit dhe drejtuesit e drejtorive komunale përkatëse | Kryetari i Komunës, Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Komuna e Gjilanit, përkatësisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe ajo e Bujqësisë me organizatën "OJQ Gruaja Hyjnore " kanë organizuar panairin tradicional "Forco Traditën". | **E realizuar**<br><br>Komuna e Gjilanit dhe shoqëria civile, ka ndërtuar marrëdhënie të fortë dhe të besueshme për të arritur qëllime të përbashkëta. | https://www.facebook.com/photo.php?fbid=1104034827946124&set=a.622743492741929&type=3 | Bashkëpunimi mes Komunës së Gjilanit dhe Shoqërisë Civile është në përgjithësi pozitiv, | Vazhdojmë tutje |
| 1.5 | | Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive në | Rishikimi i organizimit të brendshëm të | Kryetari i Komunës, | TM3 dhe TM4 2024 | Rishikimi i organizimit të brendshëm dhe sisitematizimit të vendeve të punës në administratë, bëhet në harmoni me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sisitematizimin e vendeve të punës në | **E realizuar**<br><br>Rregullorja për | https://kk.rks-gov.net/gjilan/category/rregulloret/#2020 | Rregullorja ka siguruar një strukturë të qartë dhe | Implementimi i saj është realizuar pa |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | administratën komunale | administratës përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Drejtorit Komunal e | | administratën komunale dhe Rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin civil. | Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale Gjilan / e cila është ne fuqi nga viti 2020 | https://kk.rks-gov.net-Projekt-Rregullorja | efikase të menaxhimit të administratës. | vështirësi të mëdha, |
| 1.6 | | Mos përcaktimi i qartë i përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit | Të përcaktohen përgjegjësitë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit | Kryetari i Komunës, <br><br> Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit është një detyrë e vazhdueshme dhe kërkon angazhim të përhershëm për të siguruar që masat e parashikuara janë në përputhje me objektivat e planit. <br><br> Bazuar më Udhëzuesin për Monitorimin dhe Raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit, Komuna e Gjilanit përpilon Raport të zbatimit të Planit të Integritetit për Agjencinë e Parandalimit të Korrupsionit | **Në proces** <br><br> Komuna e Gjilanit përpilon Raport të zbatimit të Planit të Integritetit për Agjencinë e Parandalimit të Korrupsionit | I realizuar / sipas vendimit te kryetarit te komunës / shiko te bashkangjitur | Divizioni për Integritet dhe Strategji (APK), jep udhëzime te sakta per Zyrtaret nga Komunat | Me suksese po realizohen plani i masave të Planit të Integritetit. |
| 1.7 | | Mungesa e monitorimit , raportimit mbi zbatimin e Planit të Integritetit dhe mungesa e njohurive të stafit të administratës në lidhje me planin e integritetit | Të monitorohet dhe raportohet rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit | Kryetari i Komunës <br><br> Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Pas emërimit të Koordinatorit për Monitorim dhe Raportim të Zbatimit të Planit të Integritetit nga Kryetari, do të implementohen procedurat e duhura për të garantuar një mbikëqyrje më të mirë dhe një raportim të rregullt dhe të saktë mbi përparimin dhe sfidat e zbatimit të planit. <br><br> Megjithatë, për shkak të mungesës së trajnimeve të vazhdueshme dhe përfshirjes së hershme të stafit në zhvillimin e planit, ka pasur një nivel të kufizuar njohurish mbi detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga ky plan. | **Në proces** <br><br> Kemi pranuar Udhëzuesin për Raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit, aktualisht po përpilohet Raport me shkrim për periudhën korrik-dhjetor 2024 Korrupsioni | Vendimi nr. 02/4035 <br><br> Vendimi per planin e integritetit (2).pdf | Edhe pse fillimisht ka pasur një nivel të kufizuar njohurish mbi Planin e Integritetit, ky problem ka filluar të adresohet menjëherë. | Nevoja për Trajnime dhe koordinimi mi me koleget nga komunat tjera! |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.8 | | Të rishikohet niveli i zbatimit dhe përditësohen masat për përmirësime | Koordinatori i planit të integritetit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Në përputhje me nevojën për përditësimin dhe përmirësimin e masave të zbatimit të Planit të Integritetit, kemi realizuar takime të rregullta me stafin udhëhëqës dhe drejtorinë komunale për t'i informuar ata mbi detyrat dhe përgjegjësitë e reja që kanë pranuar në kuadër të implementimit të këtij plani. | **Në proces**<br><br>Po punohet ne raportim periudha korrik-dhjetor 2024 Korrupsioni | Të gjitha mjetet e verifikimit janë të bashkangjitura në attachment dhe përfshihen si pjesë e raportit të dorëzuar. | Koordinatori i Planit të Integritetit nuk ka hasur në vështirësi gjatë zbatimit të detyrave. | Trajnimet janë të domosdoshme |
| 1.9 | | Takime me stafin për t'i informuar për planin e ri të integritetit | Koordinatori i planit të integritetit | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Disa herë ka pasur nevojë për përmirësimin e komunikimit dhe koordinimit ndërmjet të gjitha niveleve të administratës, për të siguruar që të gjithë janë në dijeni të përgjegjësive dhe kërkesave të planit. | **Në proces**<br><br>Koordinimi i aktiviteteve të Planit të Integritetit po bëhet përmes takimeve , shkëmbimit të e-maileve dhe bisedave e telefonike. | Ka pasur një periudhë fillestare për t'u siguruar që stafi dhe drejtoritë janë të informuara dhe të gatshme për të zbatuar masat e planit. | Nuk kemi hasur në vështirësi gjatë zbatimit të detyrave. | Nevoja për Trajnime janë të domosdoshme / pastaj mbahen tarajnime per stafin e komunës. |
| 1.10 | | Përfshirja e planit të integritetit ne Hartimin e Planit komunal të trajnimeve | Njësia e personelit | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Agjencia e Parandalimit të Korrupsionit do të duhet të organizojë takime në komuna me drejtorët dhe zyrtarët komunalë për t'i informuar ata mbi rëndësinë e Planit të Integritetit dhe masat që ky plan parashikon për parandalimin e korrupsionit. | **Në proces**<br><br>SIMBNJ – zyra ne Gjilan nuk mund të mbajnë trajnime të tilla. | SIMBNJ – Gjilan ka dy zyrtar / si me ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve për Planin e Integritetit. | Plani i Integritetit është diçka e re / eshtë ende e pa njohur për shumë zyrtarë | Nevoja për Trajnime |
| 2. | POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË PUNËSUARVE | Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuatë dhe të mjaftueshëm | Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Zhvillimi i planit të personelit bëhet nga Njësia e personelit në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale.<br><br>Ky plan aprovohet nga Kryetari i Komunës dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik (DMZP) - Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPM) | **I realizuar** \| Për shkak të daljes në pension të disa zyrtarëve komunalë gjatë këtij viti, vendet e lira janë plotësuar. | Te gjitha publiket e konkurseve shpallen web faqe te komunës.<br><br>https://kk.rks-gov.net/gjilan/category/konkurset-njoftimet/konkurset/ | Balancimi i kërkesave të ndryshme për pozita dhe kompetenca. | Gjatë vitit 2025, do të ketë dalje në pension të stafit dhe konkurse të reja për plotësimin e pozita të lira. |
| 2.1 | | Vlerësimi periodik për | Kryetari i komunës, | Kryetari i Komunës, | TM3 dhe TM4 | Zyrtarët komunal përgatisin raporte javore, mujore dhe një raport vjetor për vlerësimin e rezultateve të punës. | **E realizuar** | https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=926589489 | Zyrtari i Dalluar dhe | Do të vazhdojnë edhe gjatë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rezultatet e punës së zyrtarëve. | Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive | Drejtorit Komunal e | 2024 | Drejtoret vlerësojnë raportet dhe japin vlerësime për punën e zyrtarëve në koordinim me Zyrën e Personelit. | Është mbajtur ceremonia vjetore e ndarjes së çmimeve të mirënjohjes publike për qytetarin më aktiv, zyrtarin e dalluar dhe mirënjohje post mortum. | 577047&id=100066780141113&_rdr<br><br>https://kk.rks-gov.net/gjilan/category/konkurset-njoftimet/?page=2024<br><br>Plani i trajnimeve 2024.pdf | Qytetari më Aktiv nderojnë jo vetëm arritjet individual por edhe frymëzimin që këta individë sjellin për të gjithë ne. | vitit 2025, duke mbështetur angazhimin dhe frymëzimin për arritje të reja. |
| 2.2 | | Vendosja e kritereve të vlerësimit sipas Rregullores se klasifikimit. | Kryetari i komunës,<br><br>Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive | Kryetari i Komunës ,<br><br>Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Njësia e personelit në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale, Zyrën e kryetarit si dhe he Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publik (DMZP) - Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPM) /bënë vendosjen e kritereve të vlerësimit sipas Rregullores së klasifikimit në sigurojnë një proces të drejtë dhe transparent të vlerësimit. | **Gjithherë**<br><br>Konkurset publike në ueb faqe | https://kk.rks-gov.net/gjilan/category/konkurset-njoftimet/ | Balancimi i kërkesave të ndryshme për pozita. | Do te ketë konkurse të reja për plotësimin e pozita të lira. |
| 2.3 | | Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave në përputhje me planin dhe nevojat për trajnime | Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Instituti KAF (IKAF) ka nënshkruar marrëveshje me Komunën e Gjilanit për ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin profesional në administratën komunale dhe në sektorin e arsimit.<br>Marrëveshjet u nënshkruan nga Drejtori Ekzekutiv i IKAF-it, z. Bujar Krasniqi dhe kryetari i Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni. Ky bashkëpunim përfshin ofrimin e trajnimeve dhe çertifikimeve të dizajnuara për të rritur standardet profesionale në të dy sektorët, duke kontribuar në përmirësimin e shërbimeve dhe cilësisë së arsimit. | **Në proces**<br><br>Njoftimet për trajnime përmes komunikimit elektronik | https://www.facebook.com/KAFInstitute/posts/instituti-kaf-ikaf-ka-n%C3%ABnshkruar-marr%C3%ABveshje-me-komun%C3%ABn-e-gjilanit-p%C3%ABr-ngritjen-/947966894025758/ | Menaxhimi i kapaciteteve dhe resurseve për trajnim mund të jetë sfidues. | Varësisht nga fushat përkatëse trajnohen edhe zyrtaret komunal. |
| 2.4 | | Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura | Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura mund të bëhet përmes analizës së performancës para dhe pas trajnimit, vlerësimit të aftësive të përmirësuara, dhe feedback-ut nga pjesëmarrësit.. | **Në proces**<br><br>Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive | Po ashtu, mund të monitorohet aplikimi i njohurive dhe aftësive të reja në praktikat e përditshme të punës, si dhe përmirësimi i | Mund të jetë e vështirë të vlerësohet ndikimi i menjëhershëm, pasi aplikimi i | Nevoja për trajnime është e rëndësishme për rritjen e efikasitetit, përmirësimi |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | shërbimeve dhe cilësisë së arsimit | aftësive mund të kërkojë kohë. | n e shërbimeve publike |
| 2.5 | | Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate dhe të pa përditësuara | Të bëhet rishikimi dhe standardizimi i detyrave të punës si dhe harmonizimi i tyre me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Gjatë hartimit të Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës, rishikohet edhe përshkrimi i detyrave të punës për secilin nëpunës duke iu përshtatur katalogut të punës dhe ndryshimeve që mund të ndodhin në pozitat punuese. | **E realizuar**<br><br>Rregullorja për organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës | LIGJI NR. 06L-113 organizmi i administ | Ndryshimet në struktura mund të shkaktojnë rezistencë nga punonjësit dhe të krijojnë pasiguri. | |
| 2.6 | | Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtaret komunal. | Kryetari i komunës dhe i Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore,<br><br>Drejtoret e Drejtorive dhe<br><br>Udhëheqësit e sektorëve | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunal është e rëndësishme për sigurimin e transparencës, ndershmërisë dhe përgjegjshmërisë në administratën publike.<br><br>Kjo ndihmon në krijimin e një kulture të integritetit, parandalimin e korrupsionit dhe garantimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. | **E realizuar**<br><br>Komunikimi përmes emailit zyrtar te te gjithë punonjësit | Kodi i Etikes - Komuna e Gjilanit.p | Pa trajnime të mjaftueshme, mund të jetë e vështirë për zyrtarët të kuptojnë dhe zbatojnë rregullat e Kodit. | Nevoja për trajnime! |
| 2.7 | | Mungesa e informimit dhe sensibilizimit për ekzistencën e kodit të etikës për stafin drejtues | Organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit. | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Takimet nuk kanë arritur të mbahen me të gjithë nëpunësit \| Implementimi i Kodit te Etikes siguron standarde të qarta të sjelljes dhe veprimeve profesionale për të gjithë zyrtarët. | **Në proces**<br><br>Po punohet në implementimin e tij përmes trajnimeve, sesioneve informuese. | Kodi i Etikes - Komuna e Gjilanit.p | Edhe pse mund të ketë rezistencë nga individë brenda administratës që e shohin | Me gjithat nuk kemi hasur diçka te tille. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhe stafin tjetër të komunës | | | | | | | Kodin si një pengesë për mënyrën e zakonshme të punës. | |
| 2.8 | | Organizimi i trajnimeve me stafin e komunës për kodin e etikes | Njësia e Burimeve Njerëzore | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Implementimi i Kodit te Etikes siguron standarde të qarta të sjelljes dhe veprimeve profesionale për të gjithë zyrtarët \| Takimet nuk kanë arritur të mbahen me të gjithë nëpunësit \| | **Në proces**<br><br>Po punohet në implementi min e tij përmes trajnimeve, sesioneve informuese. | Kodi i Etikes - Komuna e Gjilanit.p | Zyrtarët mund të mos e perceptojnë rëndësinë e Kodit d | Me gjithat nuk kemi hasur diçka te tille. |
| 2.9 | | Të sigurohet mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhme ntit dhe personelit për prezantimi n dhe diskutimin për mekanizma t e raportimit të korrupsioni t dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme | Kryetari i komunës dhe Kuvendit dhe drejtuesit e drejtorive | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Ky vit do të fokusohet në organizimin e më shumë takimeve me zyrtarët komunal për të theksuar rëndësinë e Kodit të Etikës.<br><br>Këto takime do të sigurojnë informimin dhe angazhimin e të gjithë zyrtarëve për të zbatuar standardet e etikës, duke përmirësuar sjelljen dhe veprimet profesionale në administratën komunale. | **Në proces**<br><br>Ne fazën e planifikimit te takimeve neper drejtori | Njësia e Burimeve Njerëzore<br><br>Plani i trajnimeve 2024.pdf | Takimet mund të sfidohen nga prioritete të tjera administrat ive dhe mungesa e kohës për realizimin e tyre. | |
| 2.10 | | Mospranim in dhe trajtimin në mënyrë adekuate të informatave | Caktimi i zyrtarit përgjegjës për sinjalizim | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Zyrtari përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e sinjalizimit është caktuar me datë 12.03.2024.<br><br>Vështirësitë në mospranimin dhe trajtimin adekuat të informacionit nga sinjalizuesit/informatorët mund të përfshijnë | **E realizuar** | Zyra e prokurimit tani ka staf të mjaftueshëm dhe me përvojë në kryerjen e detyrave të veta. | Deri tani, nuk kemi hasur në këto probleme pasi janë | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sinjalizimeve nga sinjalizuesit /informatorët | | | | frikën nga hakmarrja, mungesën e mekanizmave të mbrojtjes dhe mosbesimin në proceset e trajtimit të denoncimeve. | | Vendimi nr.02/394 dt.12.04.2024 | krijuar mekanizma të fortë mbrojtës për sinjalizuesit, | |
| 3. | PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT DHE FINANCAVE | Planifikimi jo adekuat i buxhetit vjetor komunal | Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit. | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Komuna e Gjilanit, është njëra prej nismëtareve të projektit Buxhetimi me pjesëmarrje në nivel të Kosovës, lidhur me përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe planifikim. | **I realizuar**<br><br>Me gjithat nuk kemi pas mbështetjen nga opozita për aprovim | https://kk.rks-gov.net/gjilan/buxheti/degjimet-buxhetore<br><br>https://kk.rks-gov.net/gjilan/buxheti/kab<br><br>https://kk.rks-gov.net/gjilan/buxheti/buxheti-komunal/ | Pamundësia për të siguruar mjete buxhetore për të plotësuar kërkesat e të gjitha departamenteve. | Palët duhet të angazhohen në një dialog të hapur dhe të ndershëm |
| 3.1 | | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit | Kryetari i komunës dhe drejtoria për buxhet dhe financa | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Kemi shtuar kujdesin gjatë procesit të planifikimit dhe vlerësimit të kostove të kërkesave buxhetore.<br><br>Buxhetin e kemi përgatitur duke ndjekur një proces gjithëpërfshirës dhe transparent që adreson pritjet e qytetarëve dhe nevojat e komunës për zhvillim. | **Në proces**<br><br>USAID - projekti pesëvjeçarë "Integriteti i Komunave"- Asistenca në planifikimin e buxhetit. | https://www.usaid.gov/sq/kosovo/news/mar-14-2023-social-contract-more-inclusive-democracy | USAID-in, të cilët po monitorojnë këtë proces në kuadër të Kontratës Sociale. | |
| 3.2 | | Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore. | Kryetari i Komunës,<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Sipas ligjeve në fuqi, drejtori i buxhetit ka raportuar për shpenzimet buxhetore në mënyrë të rregullt dhe të detajuar.<br><br>Ata kane paraqitur raporte financiare periodike (mujore, tremujore dhe vjetore) për shpenzimet, duke siguruar transparencë dhe kontroll mbi përdorimin e fondeve publike. | **E realizuar**<br><br>Me gjithat nuk kemi pas mbështetjen nga opozita për aprovim | https://kk.rks-gov.net/gjilan/buxheti/raportet-financiare/<br>https://kk.rks-gov.net/gjilan/buxheti/raportet-tremujore/ | Mungesa e komunikimit të pozitës / opozitës ka bllokuar proceset | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.3 | | Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve | | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Plani siguron alokimin e fondeve në mënyrë të drejtë dhe transparente.<br><br>Është i nevojshëm një koordinim i ngushtë ndërmjet drejtorie për të siguruar se shpenzimet janë të arsyeshme dhe brenda kuadrit ligjor. | **Në proces**<br><br>Regjistrimi i planifikimit të planit të shpenzimeve regjistrohet në sistemin e SIMFK çdo fillim vit. | https://kk.rks-gov.net/gjilan/buxheti | | |
| 3.4 | | Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës | Njësia për informim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Zyra e informimit është një aset i rëndësishëm për transparencën dhe komunikimin efikas me qytetarët.<br><br>Ajo mundëson shpërndarjen e informacionit në mënyrë të shpejtë dhe të qartë, duke përfshirë publikimin e planit të shpenzimeve në faqen zyrtare të komunës.<br><br>Komuna e Gjilanit në vazhdimësi i ka drejtuar kërkesa në formë të letrave zyrtare Agjencisë Shtetërore të Informacionit për ta rregulluar problemin me serverin, në mënyrë që të bëhet funksionalizimi.<br><br>Me 15 janar, ASHI, nëpërmjet kompanisë përgjegjëse, ka lansuar webfaqet e reja, por ka lënë shumë paqartësi dhe nuk e ka bërë rivendosjen e dokumenteve sipas kërkesave të Komunës së Gjilanit, përkundër premtimeve. Të njëjtit, janë zotuar se do të realizojnë takim në formë të trajnimeve me pjesëmarrje fizike enkas për regjionin e Gjilanit, por akoma nuk e kanë bërë këtë. | https://kk.rks-gov.net/gjilan/buxheti/buxheti-komunal/ | Komuna e Gjilanit tash e më shumë se tri vite përballet me probleme serioze në aspektin e publikimeve, për shkak se në pjesën më të madhe ueb-faqja zyrtare, përfshirë administrimin, ka qenë jashtë funksionit, duke krijuar probleme serizoze sa u përket publikimeve të dokumenteve të cilat kanë afate. | Vazhdojnë mospajtimet pozitë-opozitë në Kuvendin e Gjilanit<br><br>Buxheti i vitit 2025 ende nuk është miratuar, dhe për këtë arsye nuk është publikuar ende në faqen zyrtare të komunës | Mirëmbajtja e serverit të ueb-faqeve është përgjegjësi e Agjencisë Shtetërore të Informacionit. |
| 3.5 | | Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit | Kryetari i komunës dhe Drejtoria për buxhet dhe financa | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Krijimi i një komisioni të përbërë nga përfaqësues të komunës dhe vëzhgues të OJQ-ve është një hap i rëndësishëm për sigurimin e transparencës dhe mbikëqyrjes së pavarur mbi zbatimin e buxhetit. | **Gjithherë**<br><br>Sipas ligjeve në fuqi, drejtori i buxhetit ka raportuar | https://komunat.institutigap.org<br><br>https://komunat.institutigap.org/promises/100 | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësues it e komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit. | | | | Instituti GAP dhe disa OJQ të tjera luajnë një rol kyç në përcjelljen dhe monitorimin e procesit të shpenzimeve për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie në përdorimin e fondeve publike.<br><br>Për periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2024 për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konfrom Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve Komuna e Gjilanit ka ndare gjithsej 380 000 euro.<br><br>Numri i OSHC-ve dhe individëve të përkrahura financiarisht nga komuna e Gjilanit është 117 përfitues. | për shpenzimet buxhetore në mënyrë të rregullt dhe të detajuar. | | | |
| 3.6 | | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit | Drejtoria për buxhet dhe financa | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Drejtori i buxhetit ka raportuar për shpenzimet buxhetore në mënyrë të rregullt dhe të detajuar.<br><br>Ata kane paraqitur raporte financiare periodike (mujore, tremujore dhe vjetore) për shpenzimet, duke siguruar transparencë dhe kontroll mbi përdorimin e fondeve publike. | **E realizuar**<br><br>Sipas ligjeve në fuqi, drejtori i buxhetit raporton për shpenzimet buxhetore në mënyrë të rregullt dhe të detajuar. | https://kk.rks-gov.net/gjilan/buxheti/raportet-tremujore/ | | |
| 3.7 | | Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i aseteve komunale | Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Regjistri i brendshëm i aseteve përditësohet çdo fund vit \| vendimi numër 4015/ i datës 11/09/24<br><br>SIMFK - Raportet e komisioneve të inventarizimit dhe vlerësimit | **E realizuar**<br><br>ekzistojnë edhe komisioni komunal dhe komisionet ne për drejtori | Vendimi per Inventarizim I.pdf<br><br>Vendimi per Invertarizim - DZHE.\| | Komisionet e inventarizimit nuk kanë hasur në vështirësi. | |
| 4. | RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT | Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë | | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunal e | TM3 dhe TM4 2024 | Agjencia Shtetërore e Informacionit (ASHI) është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe sigurimin e rrjetit të internetit të institucioneve shtetërore, duke garantuar që ky rrjet të jetë i sigurt, efikas dhe i besueshëm. | **E realizuar**<br><br>https://ekosova.rks-gov.net/PrivacyPolicy | Komunikimi elektronik me agjencitë dhe departamentet e Ministrive për ndryshimet në | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jo-zyrtare | | Zyra e IT | | Zyra Komunale e e IT zbatohn në vazhdimësi procedurat e brendshme të zhvilluara dhe miratuara nga Ministria e Linjës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative. | | zhvillim të procedurave | | |
| 4.1 | | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative | | | | Agjencia Shtetërore e Informacionit (ASHI) ka përcaktuar hapat, përgjegjësitë dhe masat e sigurisë për përdorimin e sistemeve, duke garantuar një menaxhim të rregullt dhe të qëndrueshëm të të dhënave dhe proceseve. | **E realizuar** | https://ekosova.rks-gov.net/PrivacyPolicy | | |
| 4.2 | | Takime informuese me stafin e komunës lidhur me rrezikun nga mashtrimet dhe korrupsioni që ka të bëjë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara | Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Agjencia Shtetërore e Informacionit (ASHI) mban takimet informuese me stafin e komunës (Zyra komunale e IT) lidhur me rrezikun nga mashtrimet dhe korrupsioni që ka të bëjë me sigurinë e informacionit janë të rëndësishme për rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e abuzimeve | **Në proces**<br><br>E/mail e dërguara nga ASHI | https://ekosova.rks-gov.net/PrivacyPolicy | | |
| 4.3 | | Trajtimi jo adekuat i dokumentacionit zyrtar dhe informacionit | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Zbatojmë procedurat e rekomanduara nga Ministritë e linjave përkatëse.<br><br>Komuna ka miratuar dhe publikuar dokumentin "Rregull e brendshme për menaxhimin e pasurisë jo financiare" dhe dokumente tjera që përcaktojnë procedurat. | **E realizuar** | https://kk.rks-gov.net/gjilan/wp-content/uploads/sites/11/2024/08/Rregull-e-brendshme-per-menaxhimin-e-pasurise- | | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | dokumentacionit dhe informacionit zyrtar | | | | | financiare.pdf<br><br>https://web.archive.org/web/20180319210420/https:/rpa.rks-gov.net/ | | |
| **Të dhënat e Planit të Integritetit** | | | | | | **Raportimi i zbatimit** | | | | |
| 1. | AUDITIMI I BRENDSHËM | Mungesa e planifikimit të auditimit të bazuar në rrezik dhe auditimeve rast pas rasti | Hartimi i planit të auditimit të brendshëm bazuar në rezultatin e vlerësimit të rrezikut | Kryetari i Komunës<br><br>Drejtorit Komunale | TM3 dhe TM4 2024 | Për çdo auditim të brendshëm hartohet apo plotësohet formulari standard nr. 1017 plani i auditimit. | **E realizuar** | Plani Strategjik i NJAB-se 2025-2027<br><br>Formulari nr. 1017 | Identifikimi i jo i mjaftueshëm i rreziqeve nga ana e njësive audituese. | Në vazhdimësi të bëhet identifikimi i rreziqeve nga ana e drejtorive komunale. |
